

**SHTOJCA 1        STATUTI DHKN-së**  
**RREGULLORJA BORDI DISIPLINOR**

**NENI 1**

**Misioni dhe qëllimi i bordit disiplinor**

Procedimi disiplinor është një mjet i nevojshëm në funksion të ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit dhe ka si qëllim kryesor të garantojë mbrojtjen efektive për të dy palët, ndërmjetësin dhe përfituesin e shërbimit.

Subjekt i procedimit disiplinor janë ndërmjetësit ndaj të cilëve janë ngritur ankesa që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit dhe objekt i investigimit është lidhja midis ndërmjetësit dhe palëve në raport me shërbimin e ndërmjetësimit të ofruar dhe përputhshmëria e veprimtarisë së ndërmjetësit me parashikimet ligjore dhe të kodit të etikës.

Qëllimi i procedimit disiplinor është sigurimi i standardeve ligjore dhe të domosdoshme në ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, si dhe marrjen e masave disiplinore ndaj ndërmjetësve që shkelin rëndë ose në mënyrë të përsëritur dispozitat e ligjit të posaçëm për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe Kodit Etik të Ndërmjetësit.

**NENI 2**

**Anëtarët e bordit disiplinor dhe përzgjedhja**

Përbërja e bordit disiplinor dhe përzgjedhja parashikohet në nenin 11/2 të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Përzgjedhja e katër anëtarëve të emëruar nga Mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve të Dhonës do të organizhet me një thirrje publike të hapur të organizuar nga Këshilli Drejtues i kësaj të fundit dhe i publikuar në faqen e saj të internetit, të paktën për 15 ditë.

Aplikuesit duhet të përmbushin kriteret si vijojnë:

1. të kenë diplomë në shkenca juridike;
2. të gëzojnë integritet profesional dhe moral dhe në ngarkim të tyre të mos jenë marrë masa disiplinore që lidhen si me ushtrimin e profesionit, ashtu edhe me kryerjen e detyrave pranë organeve publike dhe atyre private që mund të ketë ushtruar;
3. të ketë eksperiencë pune të paktën 5 (pesë) vjet në sektor ligjor dhe do të vlerësohej veçanërisht nëse ka eksperiencë në fushën e së drejtës administrative;
4. të ketë ndjekur trajnime të ndryshme në fushën e ndërmjetësimit;
5. aplikuesi nuk duhet të jetë anëtar i organeve të tjera të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve;

Këshilli drejtues i DHKN-së pasi të ketë mbledhur të gjitha kërkesat e aplikuesve, brenda 10 ditëve duhet të përzgjedhi ato që plotësojnë kriteret e lartpërmendura dhe në respekt të afateve si parashikohet në Statutin e DHKN-së për Mbledhjen e përgjithshme të ndërmjetësve, duhet t'a organizojë atë.

Fleta e votimit do të ketë emrat e të gjithë aplikuesve që përmbushin kriteret e lart përmendura dhe çdo anëtar i Mbledhjes së Përgjithshme do të votojë për katër prej tyre.

Anëtarët e Mbledhjes së Përgjithshme do të votojnë me një sistem të fshehtë anëtarët e prezantuar nga Këshilli drejtues i DHKN-së dhe fitues do të jenë katër aplikuesit që kanë marrë më shumë vota. Këshilli drejtues do të publikojë listën me numrin përkatës të votave të mbledhura.

Në rast se rezulton se ka fitues që kane të njëjtin numër votash, procesi votimit do të përsëritet për ato. Emërimi i anëtarit të caktuar nga Ministria e Drejtësisë vendoset me akt administrativ që mund të ndryshohet nga Ministria sa herë ta shohin të arsyeshme. Mandati anëtarit të bordit disiplinor zgjat 5 vjet (pesë) vjet dhe nuk mund të rizgjidhet.

### **NENI 3**

#### **Kryetari i bordit disiplinor**

Zgjedhja e Kryetarit të Bordit disiplinor parashikohet nga neni 11/2, paragrafi 1, të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve". Kryetari zgjidhet midis anëtarëve të votuar nga Mbledhja e Përgjithshme si anëtarë të bordit disiplinor. Ky i fundit duhet të organizojë zgjedhjen e Kryetarit brenda 10 ditëve nga përfundimi i zgjedhjes së tyre nga Mbledhja e Përgjithshme. Kryetar do të jetë ai që merr më shumë vota. Në rast se numri i duhur i votave nuk arrihet zgjedhja duhet të përsëritet midis personave më të votuar. Në rast rezultati të barabartë edhe në raundin e dytë, kandidati më i vjetër do të zgjidhet Kryetar.

Kryetari bordit disiplinor përveç detyrave të përcaktuara në ligj, ka edhe detyrat si vijon:

- të përfaqësojë bordin kundrejt të tretëve;
- të kryejë të gjitha komunikimet dhe të thërrasë mbledhjen e bordit;
- të thërrasë bordin disiplinor sa herë konstaton ose merr dijeni për shkelje të dispozitave të parashikuara në ligj dhe statut dhe vendimet përkatëse ti komunikojë tek këshilli drejtues i DHKN-së.

### **NENI 4**

#### **Përfundimi i parakohshëm i mandatit të anëtarit të bordit disiplinor**

Si rregull mandati i anëtarit të bordit disiplinor mbaron me përfundimin e afatit 5 vjeçar nga data e zgjedhjes. Këshilli drejtues i DHKN-së ka detyrimin të përgatise zgjedhjet të paktën 60 ditë para përfundimit të mandatit. Anëtari do të vazhdojë të mbajë pozicionin e tij deri në ditën e zëvendësimit nga zgjedhja e anëtarit të ri.

Rastet kur madati i anëtarit të bordit disiplinor përfundon para afatit do të jenë si vijon:

- kur provohet se procedura përzgjedhjes është në shkelje me nenin 11/2, të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- kur gjatë ushtrimit të detyrës dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- kur anëtarët e përzgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme mungojnë në seancat e procesit disiplinor më shumë se 3 mbledhje radhazi të Bordit Disiplinor, pa arsye ligjore. Për anëtarin e zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë, janë të njëjtat kritere, por në rastin eventual kërkohet zëvendësimi i tij/saj nga ana e organit kompetent;
- kur anëtari i Bordit Disiplinor jep dorëheqjen për arsye personale, duke i komunikuar të paktën tek Kryetari bordit disiplinor 60 ditë më pare;
- kur humbet zotësinë juridike për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- për shkelje të ligjit, Statutit dhe Kodit të Etikës së Ndërmjetësit, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, që përbëjnë akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe humbin besimin në publik dhe tek ndërmjetësit në veçanti.

Pasojat e mbarimit të mandatit të anëtarit të bordit disiplinor.

- Me përjashtim të rastit të dorëheqjes, realizimi i njërit prej rasteve të sipërpërmendura sjell si pasojë përfundimin e menjëhershëm të mandatit. I njëjti rregull është i vlefshëm edhe për anëtarin e zgjedhur nga Ministria e Drejtësisë.
- Në rast se bordi disiplinor duhet të zhvillojë mbledhje urgjente, anëtari i shkarkuar do të zëvendësohet nga anëtari tjetër që pason në listën e votuar siç parashikohet në nenin 2 më lart, deri në zgjedhjen e anëtarit të ri.

Kryetari i bordit disiplinor në çdo kohë që merr dijeni në lidhje me rastet e sipërpërmendura që çojnë në përfundimin e parakohshëm të mandatit, thërret bordin për të dalë me një vendim mbi të dhe për të informuar Këshillin drejtues të DHKN-së për të proceduar siç parashikon ligji dhe statuti.

## **NENI 5**

### **Organizimi dhe funksionimi i bordit disiplinor**

Bordi Disiplinor është një organ i DHKN-së, ai është një organ kolegjal vendimmarrës dhe funksionon në varësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve. Ajo duhet t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme të Ndërmjetësve të paktën një herë në vit dhe çdo muaj tek Këshilli drejtues. Struktura e tij është e pavarur dhe çdo anëtar vendos në bazë të gjykimit të tij / saj personal.

Bordi Disiplinor mblidhet sa herë që pranë tij depozitohet një ankesë për të filluar me procedimin si parashikohet në nenin 11/3 dhe vijues të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Mbledhja thirret dhe drejtohet nga Kryetari bordit. Në rast mungesë të Kryetarit, zëvendësohet nga anëtari më i vjetër.

## **NENI 6**

### **Shpërblimi i anëtarëve të bordit disiplinor**

Anëtarët e Bordit Disiplinor kryejnë detyrat e tyre të caktuara me ligj kundrejt shpërblimit. Paguesa duhet të rregullohet bazuar në frekuencën e takimeve dhe rasteve.

Shpërblimi i anëtarit hetues duhet të jetë më i lartë se anëtarët e tjerë.

Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Disiplinor duhet të përcaktohet nga Këshilli drejtues i DHKN-së, bazuar në detyrat dhe raportin e tyre.

## **NENI 7**

### **Procedimi disiplinor**

Procedimi disiplinor kundër ndërmjetësve rregullohet, si parashikohet në nenin 11/5 dhe vijues të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Ankesa, nga palët e përcaktuara në ligj, duhet t’i drejtohet me shkrim, Kryetarit të Bordit Disiplinor, duke ofruar të dhëna të sakta të ndërmjetësit, duke përshkruar shkeljen e mundshme të kryer dhe çdo provë tjetër të dobishme për çështjen.

## **NENI 8**

### **Procedura disiplinore dhe anëtari hetues**

Bazuar në nenin 11/5 dhe vijues të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, Kryetari i bordit disiplinor brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës, thërret anëtarët e Bordit disiplinor dhe cakton një mbledhje jo më vonë se 7 ditë, në të cilën përzgjidhet me short të fshehte, anëtari hetues i çështjes.

Nëse ndonjë nga anëtarët e Bordit Disiplinor është duke kryer tashmë një hetim në një proces tjetër disiplinor, ai / ajo do të përjashtohet nga shorti i mbajtur gjatë asaj kohe për një procedim tjetër.

Hetuesi duhet të përfundojë hetimin brenda 30 ditëve nga depozitimi i tij dhe duhet t’ia dorëzojë atë Bordit Disiplinor.

Hetuesi duhet të shkarkohet në rast konflikti interesi ose në rast se ai / ajo është i lidhur me palët, si parashikohet në kodin etik të DHKN-së.

## **NENI 9**

### **Detyrat e bordit disiplinor**

Bordi disiplinor gjatë ushtrimit të detyrave të tij, përveç atyre të parashikuara në nenet 11/2, 11/5, 11/6, 11/7 të Ligjit n. 10385/2011 i ndryshuar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, nenit 33 dhe vijues të Kodit të procedurave administrative, ka dhe detyrat si vijon:

- a) Të komunikojë me palën që ka bërë ankesën në rast se ka mungesë dokumnetacioni ose të tjera për tu plotësuar;

- b) të respektojë të drejtën e të dy palëve të përfshira për të parë dokumentet e dosjes për të pasur një kopje të tyre me shpenzimet e tyre dhe për të depozituar akte, ose prova në mbrojtjen e tyre dhe për t'i dëgjuar ato;
- c) të respektojë dhe zbatojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe dispozitat ligjore të Ligjit të Ndërmjetësimit, Statutit dhe Kodit të Etikës të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve;
- d) të ruajë sekretin e të gjitha të dhënave të komunikuara gjatë seancave të rishikimit, të cilat mund të përbëjnë një sekret të karakterit privat ose publik, si dhe ato të një natyre konfidenciale për palët në proces;
- e) të përcaktojë në mënyrë korrekte dhe të arsyeshme shkeljet e ligjit dhe akteve nënligjore, që janë subjekt i klasifikimit të shkeljes disiplinore;
- f) të respektojë afatet ligjore për përfundimin e procedurave disiplinore, sipas kërkesave të ligjit;
- g) të sigurojë dhe garantojë palët për një proces të ndershëm, transparent dhe të paanshëm dhe pasqyrimi i integritetit moral dhe profesional në shqyrtimin e çështjes

## **NENI 10**

Bordi Disiplinor nuk mund të marrë në konsideratë dhe, nëse pranohet nga anëtari i hetimit, ankesa duhet të pezullohet menjëherë, në rastet e mëposhtme:

- a) kur po zhvillohet një proces gjyqësor penal ose civil për çështjen në shqyrtim. Në një rast të tillë, vendimi përfundimtar i gjykatës duhet të pranohet pa kundërshtim nga Bordi Disiplinor.
- b) kur objekti i paraqitur nga palët ankuese përbën një vepër penale, sipas parashikimeve të Kodit Penal në Republikën e Shqipërisë, ankesa tek organet kompetente në një rast të tillë mund të bëhet vetëm nga palët ankuese.
- c) kur procesi disiplinor devijon nga objekti i ankimit të paraqitur ose mosmarrëveshja midis palëve nuk ka karakter administrativ.
- d) kur verifikimi i çështjes së paraqitur në ankesë kërkon ekspertizë të veçantë dhe që mund të kryhet vetëm nga organe të specializuara.

## **NENI 11**

### **Vendimi i bordit disiplinor dhe ankimi**

Në përfundim të procesit disiplinor dhe dorëzimin e raportit përfundimtar së bashku me propozimin për masën disiplinorë të përgatitur nga anëtari hetues, kryetari bordit, cakton mbledhjen përkatëse jo më herët se 3 ditë, nga dorëzimi, për ti dhënë mundësinë anëtarëve ta shqyrtojnë atë.

Bazuar në nenin 11/7 të Ligjit nr. 10385/2011, i ndryshuar "Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", bordi vendos me shumicën e votave të anëtarëve me të drejtë vote. Hetuesi i çështjes përjashtohet nga votimi. Prosesi i votimit nuk është i vlefshëm nëse janë të pranishëm më pak se tre anëtarë. Në rast barazie, vota e Kryetarit është vendimtare.

Vendimi i bordit disiplinor duhet t'u njoftohet palëve brenda 10 ditëve nga shpallja e tij.

Kundër vendimit të bordit disiplinor, pala mund të ankohet brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Rrethit Administrativ.